



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës së Junikut;  
Komiteti për Politikë dhe Financa;  
Numër: 02-05/24;  
Datë: 15.05.2024.

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa iu bënë këtë:

### FTESË

Për: anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa;  
Nga: Shpejtim Gacaferi - kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa;  
Lënda: mbledhja e pestë (5) (2024) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa;  
Vendi: salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Junikut;  
Data: 22.05.2024, ora 10<sup>00</sup>.



### Rendi i ditës:

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për nxerrjen e vendimit për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale për vitin 2025;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për nxerrjen e vendimit për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshimin e rregullores për tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2025;
5. Pyetje nga anëtarët e KPF-së;
6. Të ndryshme.



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK  
01/Nr. Prot. 2-155/4163  
Një. Org. 2  
Nr. i faq. 1  
Data 14.05.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	14.05.2024
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës, Junik
NGA/OD/FROM:	znj. Vjollca Qestaj - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në KPF dhe në Kuvend nxjerrjen e vendimit për fillimin e procedurave për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale për vitin 2025.

I nderuar,

Në bazë të ligjit për Vetëqeverisje lokale 03/L-040, neni 12, pika c, Ligjit për Financat e Pushtetit lokal: Nr. 03/L-049, neni 8 dhe Rregullores së punës së Kuvendit, kërkojmë që të nxirret vendimi për lejitimin e fillimit të procedurave për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale për vitin 2025.

Arsyetim:

Plotësim- ndryshimi i rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale, siç rregullohet me ligjet në fuqi duhet të kalojë çdo vit në Kuvendin Komunal për rishqyrtim.

Me respekt!



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
 REPUBLIC OF KOSOVA  
 KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. 2-955/4164  
 Nr. i faq. 2  
 Data 14.05.2024



REPUBLICA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
 KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



DATE/A:	14.05.2024
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës, Junik
NGA/OD/FROM:	znj. Vjollca Qestaj - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në KPF dhe në Kuvend nxjerrjen e vendimit për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshimin e rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024.

I nderuar,

Bazuar në ligjin për Vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 neni 12, ligjin nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 12, Statutit të Komunës së Junikut nr. 001-3127 i datës 29.09.2010 neni 20, rregullores nr. 02/2021 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve komunale, neni 14, si dhe Rregulloren e punës së Kuvendit Komunal Junik, kërkojmë që të nxirret vendimi për lejimin e fillimit të procedurave për ndryshimin e Rregullores së Tatimit në Pronën e Paluajtshme për vitin 2025.

Arsyetim:

Komunat çdo vit aprovojnë Rregulloret e Tatimit në Pronë paralelisht me aprovimin e Buxhetit komunale. Sipas ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe udhëzimit nr. 08/2019 për metodologjinë e Vlerësimit të Pronës së Paluajtshme, Komuna shqyrtojnë dhe përcjellin vlerën e tregut të çdo pronë që është nën juridiksionin e tyre për çdo tre deri në pesë vite, andaj kërkojmë që ky vlerësim të bëhet edhe këtë vit.

Me respekt!



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova  
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

## KOMITETI PER POLITIKË DHE FINANCA

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 02-04-24

Datë: 22.04.2024, ora 10<sup>00</sup>

### PROCESVERBAL

i

Mbledhjes së Katërt të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur me datë 22 Prill, 2024, në orën 10<sup>00</sup>, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti, si në vijim:

1. Shpejtim Gacaferi, kryesues (LDK),
2. Rajmonda Krasniqi, përfaqësuese (AAK),
3. Xhemë Tofaj, përfaqësues (LVV),
4. Dervish Bajraktari, përfaqësues (AAK), dhe
5. Ermelinda Lolluni përfaqësuese (LDK).

Poashtu të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i Komunës z. Ruzhdi Shehu, nënkryetari z. Besart Tofaj, drejtoresha për Administratë znj. Leonora Shehu, drejtoresha për Buxhet dhe Financa znj. Vjollca Qestaj, drejtori për Zhvillim Ekonomik z. Jetmir Jasiqi, drejtori i Arsimit z. Xhavit Velijaj dhe drejtori për Shërbime Publike z. Demokrat Ganijaj.

Mbledhjen e Katërt të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa e shpalli të hapur kryesuesi i këtij Komiteti z. Shpejtim Gacaferi, ndërsa ceku se në këtë mbledhje të KPF-së të pranishëm janë të gjithë anëtarët.

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi kërkoj miratimin e Rendit të Ditës, si në vijim;

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën Janar-Mars, 2024,
4. Ndryshimi i planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2023, sipas programeve,
5. Informatë lidhur me gjendjen e shërbimeve publike në Komunën e Junikut,
6. Informatë lidhur me gjendjen e arsimit në Komunën e Junikut,
7. Lirimi nga detyra dhe zëvendësimi i anëtares së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit, dhe
9. Të ndryshme.

Kryesuesi hodhi në votim Rendin e Ditës, i cili me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e KPF-së.

### **Pika e Parë** **Arsyetimi i mungesave në mbledhje**

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi tha, të gjitha anëtarët janë të pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, prandaj nuk ka arsyetim të mungesave në këtë mbledhje.

### **Pika e Dytë** **Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi kërkoj shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, i cili u shqyrtua, dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratuan nga anëtarët e KPF-së.

### **Pika e Tretë** **Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën Janar-Mars, 2024**

Z. Shpejtim Gacaferi tha, sipas ligjit mbi menaxhimin e financave, ekzekutivi është i obliguar që t'i raportoj KPF-së dhe Kuvendit për shpenzimet buxhetore në afatet tremujore, ndërsa fjalën i kaloj drejtoreshës për buxhet dhe financa znj. Vjollca Qestaj e cila tha, raporti i buxhetit për periudhën Janar-Mars 2024 është informata e parë që ne si ekzekutiv e japim para KPF-së dhe Kuvendit, dhe e cila si informatë prezanton të gjithë treguesit në 14 programet buxhetore, aq sa i ka organizata jonë buxhetore. Në vazhdim drejtoresha lexoj dhe shpjegoj të hyrat dhe shpenzimet periodike për secilën kategori buxhetore, ndërsa paraqiti shumat, shifrat, përqindjet, si dhe tabelat grafike të këtij raporti financiar për periudhën Janar-Mars 2024.

Z. Dervish Bajraktari pyeti lidhur me shumën prej 912.60 €, shpenzimi për anëtarësim në kuadër të zyrës së kryetarit, në faqen 9 të këtij raporti, dhe kompensimi i përfaqësimit brenda vendit, në vlerë prej 3733.00 €, dhe shpenzimet për telefonat mobil gjatë periudhës Janar-Mars, në shumën prej 1265.00 €.

Znj. Vjollca Qestaj tha, këto janë në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, ku ne rregullisht marrim trajnime dhe konsulenca për secilën drejtorive, dhe çdo vit ne paguajmë një kosto fikse për këto shërbime. Ndërsa, kompensimi i përfaqësimit brenda vitit përfshinë drekat zyrtare, festat e ndryshme, siç është ajo e Ditës së Mësuesit, Dita e Vrapimit të Pavarësisë dhe festa e aktivitete të tjera të ngjashme. Pra, këto janë shpenzime brenda drejtorive komunale. Dhe, pyetja tjetër ishte për shpenzimet për telefonat mobil. Ne tani e dy vite kemi kontratë me operatorin ekonomik Vala, ku pothuajse të gjithë zyrtarët e Komunës janë të përfshirë në këtë ofertë për komunikim brenda zyrtarëve në kuadër të Komunës, përveç zyrtarëve të Kuvendit, të cilët nuk e kanë pranuar këtë shërbim.

Z. Dervish Bajraktari pyeti edhe për shpenzimet e veçanta konsulete prej 20,612.40 €.

Znj. Vjollca Qestaj tha, ky shpenzim është vetëm te QKMF-ja, që ka të bëj me shërbimet 24 orë në shëndetësi.

Z. Shpejtim Gacaferi pyeti për inkasimin e të hyrave nga qiratë në shumën prej 1650.00 €, që janë objekte publike.

Znj. Vjollca Qestaj tha, te Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik kemi një qira që çdo vit e paguan fabrika e ujit, dhe ky është një borxh i mbledhur.

### **Pika e Katërt**

#### **Ndryshimi i planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2023, sipas programeve**

Znj. Vjollca Qestaj tha, kjo ka të bëjë me planin e ndryshimit të buxheti për të hyrat vetanake për vitin 2023, është fjala për të hyrat e realizuara për muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor, të cilat nuk janë alokuar në vitin 2023. Në mënyrë që këto të barten për shpenzim në vitin 2024 është e nevojshme që të bëhet ndryshimi i planifikimi të buxhetit, të cilat janë të prezantuara, dhe të cilat shkojnë në kodin për bashkëfinancim, të cilat janë të prezantuara dhe shpjeguara në tabelë. Kjo kërkon edhe miratimin nga KPF-ja dhe Kuvendi.

Kryesuesi hodhi në votim këtë pikë, e cila me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e KPF-së.

### **Pika e Pestë**

#### **Informatë lidhur me gjendjen e shërbimeve publike në Komunën e Junikut**

Z. Demokrat Ganijaj tha, po filloj me ndriçimin publik, që është i shtrirë thuajse në gjithë Komunën e Junikut. Ne kemi një kontratë për mirëmbajtjen e ndriçimit publik që mendoj se është në nivelin e duhur, pavarësisht që kemi patur disa probleme gjatë reshjeve atmosferike, mirëpo tani i gjithë rrjeti është funksional.

Këtë vit planifikojmë që të zgjerojmë ndriçimi publik nëpër disa rrugë dhe lagje që nuk janë të përfshira. Sa i përket mbeturinave qëndrojmë mirë. Shërbimi është i shtrirë në të gjithë territorin e Komunës. Këtë vit planifikojmë që të fillojmë me riciklimin e letrës dhe plastikes.

Në kuadër të kontratës për menaxhimin e mbeturinave kemi edhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, ku është bërë pastrimi i rrugëve dhe trotuareve, dhe tani kohëve të fundit kemi filluar edhe kositjen e hapësirave të gjelbërta, pra parqet nëpër Junik.

Sa i përket kanalizimit vitin e kaluar kemi pasë shtim të këtyre kanaleve në lagjet Qok dhe Moronicë. Që nga viti i kaluar kemi një kontratë për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e kanalizimit me kompaninë Hidrodrini.

Sa i përket mirëmbajtës dimërore kemi ndërhyrë përmes kompanisë që e kemi të kontraktuar dhe kemi bërë mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, siç është pastrimi i borës dhe shpërndarja e kripës aty ku ka qenë e nevojshme.

Sa i përket infrastrukturës në kuadër të kontratës për rehabilitimin e rrugëve lokale kemi ndërhyrë në shfrytëzimin e disa pozicioneve, ku është bërë edhe pastrimi i të gjitha kanaleve, dhe është bërë pastrimi i të gjitha hyrjeve të rrugëve kryesore të Junikut, dhe largim i barishteve të egra skaj këtyre rrugëve.

Z. Dervish Bajraktari tha, në lagjen Bajraktar ka pas një shtyllë të rrëzuar dhe akoma aty nuk është vendosur drita, ndërsa në lagjen Gaxherr, të Kroni i Madh mungon kapaku i një shakti të kanalizimit, që paraqet rrezik për qytetarët.

Z. Demokrat Ganijaj tha, lidhur me shtyllën ne iu kemi drejtuar me një kërkesë KEDS-it, dhe ajo shtyllë është ndërruar, ndërsa lidhur me kapakun e pusëtës është intervenuar dhe është vendosur ai kapak.

Znj. Rajmonda Krasniqi tha, në rrugën Bajraktar-Gaxherr janë dy shtylla që janë gati që të rrëzohen, ndërsa shtyllat elektrike të rrëzuara nga era nëpër livadhe, të cilat paraqesin rrezik nuk janë riparuar, ndërsa kërkoj shpjegim për këtë.

Z. Demokrat Ganijaj tha, ne kemi bërë shumë kërkesa lidhur me këto shtylla të KEDS-i, mirëpo ata nuk janë përgjigjur gati në asnjërin për këtyre, vetëm në ndonjë rast emergjent. Ne jemi duke e bërë punën tonë me adresimin e këtyre kërkesave të cilat i dëshmojmë edhe me fotografi, mirëpo është e kundërligjshme që ne të investojmë në këtë fushë. Kjo është në ndërgjegjen dhe përgjegjësinë e KEDS-it.

Kryetari z. Ruzhdi Shehu kërkoj që këto kërkesa të bëhen publike.

## **Pika e Gjashtë**

### **Informatë lidhur me gjendjen e arsimit në Komunën e Junikut**

Lidhur me këtë pikë fjalën e mori drejtori i arsimit në Komunën e Junikut z. Xhavit Velijaj i cili për të pranishmit paraqiti dhe lexoj informatën lidhur me gjendje në arsim në shkollat e Komunës së Junikut, ku ceku se procesi mësimor në shkolla është i organizuar vetëm në ndërrimin e paradites për të gjitha nivelet e shkollave.

Mësimi fillorë që nga Dhjetori i vitit të kaluar është duke u zhvilluar në objektin e ri të shkollës.

Në vazhdim, drejtori paraqiti numrin e nxënësve të të gjitha niveleve në shkollë, pra të të gjitha grupmoshave, numrin e përgjithshëm të stafit të arsimit, përfshirë mësimdhënësit, drejtorët, sekretarët, punëtorët teknikë dhe mirëmbajtësit, si dhe një pedagog dhe një psikologe në kuadër të stafit të arsimit. Z. Xhavit Velijaj ceku se infrastruktura në shkolla është e mirë dhe e pajisur me orendi dhe mjete të punës për kabinetet e TIK-ut të fizikës, biologjisë, kimisë, matematikës dhe edukatës fizike, kurse furnizimi me materiale shpenzuese higjienike është i mirë, si dhe furnizimi për ngrohje me dru dhe pelet gjatë sezonit të dimërorë ka qenë i mirë dhe i mjaftueshëm.

Ndërsa tha se siguria në shkolla është e mirë dhe shkollat janë të pajisura me kamera të sigurisë, kurse policia çdo ditë pune kujdeset për sigurinë në komunikacion për nxënësit e shkollës fillore përpara fillimit të mësimt.

Tjetër, drejtori ceku se janë mbajtur aktivitete të ndryshme në shkolla, siç janë; vaksinimi i rregullt për grupmoshat 5-7 vjeç, dhe vaksinimi kundër kancerit të qafës së mitrës për vajzat e moshës 11-12 vjeç. Në muajin Shkurt në shkollën fillore është mbajtur ligjërata me temën “narkotikët dhe pasojat e drogës”, ndërsa, në Gjimnaz dhe në Shkollën Fillore nga Forca e Sigurisë së Kosovës është mbajtur ligjërata me temën “Mjetet e pa shpërthyer Eksplozivët-Minat”.

Poashtu muajin Shkurt nxënësit e klasës së VII-3 duke plotësuar kriterin e përcaktuar nga (MASHTI) si paralelja më e mirë, kanë qenë në Brezovicë për 5 ditë, në kuadër të shkollës dimërore të skijimit, projekti “Drejt Malit” në programin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim të MASHT-it, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sportit Shkollor të Kosovës.

Znj. Rajmonda Krasniqi tha, unë jam e shqetësuar sa u përket uniformave të nxënësve, të cilat janë jofunksionale, siç është patenti uniformës, si dhe dëmtimi i materialit të tyre, sidomos te duksat, dhe do të kishte qenë mirë që kompanisë në fjalë t'i bëhet një kërkesë për rishikimin e tyre, dhe të bëhet një zgjidhje lidhur me këtë.

Z. Xhavit Velijaj tha, ky proces është zhvilluar brenda shkollës nga komisioni dhe është përcaktuar kompania furnizuese, të cilët duhet të përgjigjen për këtë, ndërsa me këtë çështje duhet të merret edhe Këshilli i Prindërve të Shkollave dhe Drejtoria e Shkollës.

Z. Xhemë Tofaj pyeti për funksionin e katër punëtorëve teknik dhe një mirëmbajtësi, të cekur në këtë raport.

Z. Xhavit Velijaj tha, kjo është për arsye e rritjes së hapësirës së shkollës, që tani është rreth 4000<sup>2</sup>, pra këta janë pastruesit dhe një shtëpiak për mirëmbajtje.

### **Pika e Shtatë**

#### **Lirimi nga detyra dhe zëvendësimi i anëtares së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**

Z. Besart Tofaj koordinator i KKSB-së tha, në mbledhjen e mbajtur me 28.03.2024 jemi njoftuar se zyrtarja për barazi gjinore dhe njëkohësisht anëtarja e KKSB-së znj. Xhevahire Krasniqi është liruar nga detyra dhe ka kaluar në një pozite tjetër të punës jashtë institucionit të Komunës, ndërsa kryetari i Komunës ka marrë vendim që këto detyra përkohësisht t'i delegohen zyrtares, znj. Ariola Krasniqi.

Edhe kjo pikë e rendit të ditës me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e KPF-së.

### **Pika e Tetë**

#### **Pyetje nga anëtarët e Kuvendit**

Për këtë pikë nuk pati ndonjë pyetje nga anëtarët e KPF-së.

### **Pika e Nëntë**

#### **Të ndryshme**

Z. Xhemë Tofaj tha kemi pyetje nga qytetarët për subvencionet dhe martikulimin (vendosjen e numrit identifikues) tek bagëtitë, ku qytetarëve u është thënë se ka mungesë të këtyre numrave.

Drejtori, z. Jetmir Jasiqi tha, afati për matrikulim ka qenë deri me 13 Prill, 2024, por ky afat është shtyrë nga ministria për shkak të mungesës së veterinarëve deri me 29 Prill. Pra, kjo është për shkak se për tani nuk ka ndonjë veterinarë të licencuar në Komunën e Junikut. Ne i kemi bërë kërkesat dhe jemi duke pritur, ndërsa edhe licencimi për këtë bëhet nga Ministria.

Z. Dervish Bajraktari pyeti se kur do të bëhet përfundimi i rrugës në lagjen Krasniq, dhe tha, unë çështje e kam ngritur edhe në mbledhjet e mëhershme. Kjo rrugë në raste bëhet e pakalueshme për shkak të gropave, ndërsa kërkoj që të bëhet kërkesë të operatori ekonomik që kjo të përfundoj sa më shpejtë.

Lidhur me këtë kryetari, z. Ruzhdi Shehu tha se alokimi i mjeteve për këtë bëhet këtë vit.

Z. Dervish Bajraktari ngriti edhe çështjen e qenve endacakë, dhe poashtu tha se ky është një problem i kahershëm.

Z. Ruzhdi Shehu tha, kam bërë kërkesa të shumta, por ky është një problem në nivel të vendit, dhe kjo nuk është në kompetence të Komunës por të Ministrisë. Kohë më parë është bërë edhe sterilizimi, mirëpo kjo nuk është zgjidhja.

Z. Xhemë Tofaj tha, unë nuk pajtohem se kjo duhet të zgjidhet vetëm në kuadër të Ministrisë, por edhe Komuna duhet të marrë masa.



Z. Dervish Bajraktari pyeti se kur do të bëhet zërimi i sallës së Kuvendit.

Kësaj pyetje iu përgjigj kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi i cili tha, kjo është paraparë që të bëhet këtë vit, dhe buxheti i Kuvendit është i ndarë për këtë, ndërsa një pjesë e këtij buxheti do të shfrytëzohet për zërimin e sallës së Kuvendit.

Z. Shpejtim Gacaferi kërkoi nga drejtori z. Jetmir Jasiqi që të adresohet dhe të shqyrtohet çështja e kanalit të ujit në lagjen Gacafer, i cili ka rënie të kundërt të ujit, dhe i cili bllokohet dhe shkakton dëme, ndërsa kërkoi që të merren masa për rregullimin e tij.

Z. Dervish Bajraktari kërkoi që anëtarët e Kuvendit të pajisen me kartelë të identifikimit si anëtarë të Kuvendit, siç e ka bërë edhe Komuna e Deçanit.

Z. Shpejtim Gacaferi tha, edhe kjo kërkesë do të merret parasysh.

Me kaq, kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi e shpalli të mbyllur këtë mbledhje të KPF-së.

---

Gëzim Geci-Procesmbajtës

---

Shpejtim Gacaferi-Kryesues